



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME

Dokument parlamentar

Tiranë, më 31.10. 2022

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2023”

(Shqyrtimi në parim për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme)

HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme në mbledhjen e datës 31.10.2022, mori në shqyrtim në parim projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023” për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 78-85 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit ishin të pranishëm: znj. Artemis Malo, Zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Gazmend Turdiu, Sekretar i Përgjithshëm, z. Sokol Dedja, Drejtor i Përgjithshëm për Çështjet Politike dhe Strategjike dhe znj. Ilda Dega, Drejtore e Financës në MEPJ.

BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënese të Këshillit të Ministrave. Projektligji i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të veçantë shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projekt buxheti i MEPJ për vitin 2023 është pjesë e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024. Hartimi i projektbuxhetit të MEPJ është përgatitur në funksion të aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ, përfshirë këtu edhe misionet diplomatike dhe postet konsullore jashtë vendit. Planifikimi ka në themel objektivat e përcaktuara të Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim si dhe Planin Kombëtar të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian.

Për vitin 2023 projektbuxheti mundëson vazhdimin normal të përfaqësimit të Shqipërisë në shtetet ku jemi akredituar, si dhe zbatimin e strategjive, politikave, objektivave të shërbimit të jashtëm.

Për sa më sipër, orientuar nga prioritetet e politikës së jashtme, projektbuxheti i vitit 2023 mundëson kapacitetet e domosdoshme të mbështetjes financiare për realizimin e objektivave të saj, konkretisht:

- Nisja e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin e Evropian, me Konferencën e parë Ndërqeveritare;
- Forcimi i strukturës negociuese nga baza në majë, nëpërmjet rregullimeve ligjore dhe rritjes së aftësisë të administratës shqiptare për avancimin në negociatat e anëtarësimit në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri;
- Zhvillimi i kapacitetit koordinues të MEPJ nëpërmjet forcimit të Drejtorisë së BE-së (Sekretariatit të Integritimit Evropian) dhe misionit të Republikës së Shqipërisë në Bruksel, si dy hallka të rëndësishme të strukturës negociuese;
- Vijimi i komunikimit intensiv me vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit për të siguruar bashkëpunimin sa më të afërt dhe efektiv gjatë periudhës së shërbimit si anëtar jo i përhershëm i KS të OKB-së;
- Performanca e lartë e strukturave në MEPJ dhe e Misionit të Përhershëm të RSH në OKB, me qëllim realizimin e një përfaqësimi sa më dinjitoz në KS/OKB;
- Forcimi i marrëdhënieve me vendet e Rajonit dhe bashkëpunimit rajonal;
- Konsolidim i marrëdhënieve me Kosovën, përmes G2G, zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta, angazhimit për njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, etj.
- Forcimi i kohezionit të shqiptareve në rajon;
- Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partnerët strategjik, vendet mike dhe aleate;
- Zbatimi i Strategjisë kombëtare të diasporës Shqiptare 2021-2025; mbështetja dhe organizimi i diasporës duke synuar rritjen e besimit të saj tek mekanizmat e zbatimit, regjistrimin e diasporës dhe rrjetëzimin e grupeve të profesionistëve në diasporë;

- Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për të gjetur mundësi dhe zbatuar projekte që i sjellin shqiptarët e diasporës gjithmonë e më afër vendit të tyre. Marrëveshje me vende të ndryshme që synojnë të ndihmojnë dhe lehtësojnë jetën e përditshme të diasporës (marrëveshje për njohjen e lejeve të drejtimit dhe ato për sigurimet shoqërore);
- Modernizimi i shërbimeve konsullore në përmbushje të detyrave që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Diasporën, duke synuar përafrimin e diasporës me vendin, identifikimin e nevojave dhe problemeve të tyre dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e tyre në vendin pritës.

DISKUTIMET NË KOMISION

Znj. Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit, fillimisht ia dha fjalën znj. Artemis Malo, Zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme, për paraqitjen e projekt-buxhetit.

Znj. Malo, u shpreh se përpilimi i buxhetit 2023 është bërë në një kontekst tepër sfidues si rezultat i situatës kritike të krijuar nga agresioni i Rusisë kundër Ukrainës, pjesëmarrjes së Shqipërisë në KS të OKB, rritja e rolit të Shqipërisë në rajon, etapës së re në të cilën kanë hyrë proceset integruese në BE, intensifikimi i punës me diasporën etj. Pasi bëri një pasqyrë të aktivitetit të MEPJ, Zëvendësministrja Malo tha se projekt buxheti për vitin 2023, do t'i shërbejë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për realizimin e prioriteteve të përcaktuara.

Me projektbuxhetin e vitin 2023, do të financohen politikat si :

1. Mbështetja financiare për funksionimin e misioneve diplomatike, ofrimin e shërbimeve konsullore si dhe përballimin e kostos për aktivitetet diplomatike të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore në funksion të objektivave politiko-diplomatike;
2. Organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, me fokus nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe me vendet anëtare të BE-së, zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve bilaterale me partner strategjik, vendet fqinje, mike dhe aleate, përfshirë diplomacinë ekonomike;
3. Zhvillimi, koordinimi dhe pjesëmarrja në aktivitetet e zhvilluara në kuadër të anëtarësimit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së;
4. Mbështetja e aktiviteteve dhe veprimtarive në kuadër të intensifikimit të marrëdhënieve me vendet e Bashkimit Evropian dhe angazhimit pro-aktiv në organizatat ndërkombëtare;
5. Mbështetja financiare e rolit të Shqipërisë si anëtare në organizatat ndërkombëtare dhe forume shumëpalëshe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive dhe përmbushjes së detyrimeve të anëtarësimit në këto organizata;
6. Mbështetja dhe organizimi i diasporës shqiptare, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021-2025, duke synuar rritjen e besimit të saj tek mekanizmat e zbatimit, regjistrimin e diasporës dhe rrjetëzimin e grupeve të profesionistëve në diasporë, modernizimin e shërbimeve konsullore duke synuar përafrimin e diasporës me vendin.

Në fjalën e saj ajo theksoi se buxheti për vitin 2023 ka një ulje prej 5% krahasuar me atë të vitit paraardhës. Pakësimi i buxhetit për vitin 2023 konsiston në ndryshimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sipas së cilës drejtimi teknik dhe bashkërendimi i procesit të integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian tashmë i ka kaluar në kompetencë Kryenegociatorit. Gjithashtu edhe Koordinimi i Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s i ka kaluar Agjencisë Shtetërore të Programit Strategjik dhe Koordinimin të Ndihmës (SASPAC), proces i cili shoqërohet edhe me kalimin e burimeve njerëzore dhe të fondeve buxhetore në strukturën buxhetore të institucioneve përkatëse.

Z. Etien Xhafaj, në cilësinë e relatorit, falënderoi zëvendësministren për prezantimin konkret. Ai u shpreh se projektbuxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në parim i plotëson nevojat në lidhje me detyrat e objektivat për vitin 2023. Ulja prej 5% justifikohet me transferimin e disa kompetencave nga MEPJ tek institucionet e tjera. Gjithashtu kriza ndërkombëtare e justifikon përpilimin e kujdesshëm të buxhetit për vitin 2023.

Më tej, anëtarët e Komisionit diskutuan mbi projektbuxhetin dhe shprehën vlerësimet dhe sugjerimet e tyre që planifikimi të mbështesë nevojat për përmbushjen optimale dhe efektive të objektivave të politikës së jashtme. Deputetët e opozitës ngritën shqetësimin për nivelin e ulët të buxhetit dhe theksuan domosdoshmërinë e rritjes së tij në një masë të konsiderueshme.

Znj. Mimi Kodheli, shprehu mirëkuptimin për buxhetin në kushtet e nevojës për menaxhimin e krizës. Ajo theksoi nevojën e forcimit të diplomacisë ekonomike për mbështetje të prioritetëve tona dhe gjetjen e burimeve alternative për financimin e projekteve në mbështetje të diasporës. Në përfundim të diskutimeve, ajo falënderoi të gjithë kolegët për kontributin e tyre dhe ftoi Komisionin për të votuar projektligjin në parim.

PËRFUNDIME

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën, nenet 78,83, pika 1 dhe 158 të saj dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi **në parim** buxhetin 2023 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe, pasi e miratoi atë, me shumicë votash (8 pro, 1 kundër), u shpreh dakord për kalimin e tij tek Komisioni për Ekonominë dhe Financat si komision përgjegjës për shqyrtim, miratim dhe paraqitje të projektligjit “Për Buxhetin e vitit 2023” në seancë plenare.

RELATOR

Etjen XHAFAJ

KRYETARE

Mimi KODHELI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME

Dokument parlamentar

Tiranë, më 14.11. 2022

RAPORT

(Për dhënie mendimi)

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2023”
për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme
(shqyrtimi nen për nen)

HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme në mbledhjen e datës 14.11.2022, mori në shqyrtim nen për nen projektligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023” për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 78-85 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e Komisionit për paraqitjen e projektligjit ishin të pranishëm: znj. Megi Fino, Zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Gazmend Turdiu, Sekretar i Përgjithshëm, dhe znj. Ilda Dega, Drejtore e Financës në MEPJ si dhe z. Gentian Opre, Drejtor i Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave. Projektligji i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

Projektligji për buxhetin i nënshtrohet një procedure të veçantë shqyrtimi, e cila është e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit, në nenet 78-85 të saj.

QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projekt buxheti i MEPJ për vitin 2023 është pjesë e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024. Hartimi i projektbuxhetit të MEPJ është përgatitur në funksion të aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ, përfshirë këtu edhe misionet diplomatike dhe postet konsullore jashtë vendit. Planifikimi ka në themel objektivat e përcaktuara të Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim si dhe Planin Kombëtar të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian.

Projekt buxheti për vitin 2023, do t'i shërbejë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për realizimin e prioritetëve të përcaktuara. Me projektbuxhetin e vitin 2023, do të financohen politikat si :

1. Mbështetja financiare për funksionimin e misionëve diplomatike, ofrimin e shërbimeve konsullore si dhe përballimin e kostos për aktivitetet diplomatike të misionëve diplomatike dhe posteve konsullore në funksion të objektivave politiko-diplomatike;
2. Organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, me fokus nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe me vendet anëtare të BE-së, zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve bilaterale me partner strategjik, vendet fqinje, mike dhe aleate, përfshirë diplomacinë ekonomike;
3. Zhvillimi, koordinimi dhe pjesëmarrja në aktivitetet e zhvilluara në kuadër të anëtarësimit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së;
4. Mbështetja e aktiviteteve dhe veprimtarive në kuadër të intensifikimit të marrëdhënieve me vendet e Bashkimit Evropian dhe angazhimit pro-aktiv në organizatat ndërkombëtare;
5. Mbështetja financiare e rolit të Shqipërisë si anëtare në organizatat ndërkombëtare dhe forume shumëpalëshe nëpërmjet pjesëmarrjes aktive dhe përmbushjes së detyrimeve të anëtarësimit në këto organizata;
6. Mbështetja dhe organizimi i diasporës shqiptare, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021-2025, duke synuar rritjen e besimit të saj tek mekanizmat e zbatimit, regjistrimin e diasporës dhe rrjetëzimin e grupeve të profesionistëve në diasporë, modernizimin e shërbimeve konsullore duke synuar përafrimin e diasporës me vendin.

DISKUTIMET NË KOMISION

Znj. Mimi Kodheli, Kryetare e Komisionit, fillimisht ia dha fjalën znj. Megi Fino, Zëvendësministre për Evropën dhe Punët e Jashtme, për paraqitjen e projekt-buxhetit.

Znj. Fino, u shpreh se sikurse ishte theksuar edhe në mbledhjen e mëparshme, përpilimi i buxhetit 2023 është bërë në një kontekst tepër sfidues si rezultat i situatës kritike të krijuar nga agresioni i Rusisë kundër Ukrainës, pjesëmarrjes së Shqipërisë në KS të OKB, rritja e rolit të Shqipërisë në rajon, etapës së re në të cilën kanë hyrë proceset integruese në BE, intensifikimi i punës me diasporën etj.

Për vitin 2023 projektbuxheti mundëson vazhdimin normal të përfaqësimit të Shqipërisë në shtetet ku jemi akredituar, si dhe zbatimin e strategjive, politikave, objektivave të shërbimit të jashtëm.

Për sa më sipër, orientuar nga prioritetet e politikës së jashtme, projektbuxheti i vitit 2023 mundëson kapacitetet e domosdoshme të mbështetjes financiare për realizimin e objektivave të saj, konkretisht:

- Nisja e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin e Evropian, me Konferencën e parë Ndërqeveritare;
- Forcimi i strukturës negociuese nga baza në majë, nëpërmjet rregullimeve ligjore dhe rritjes së aftësisë të administratës shqiptare për avancimin në negociatat e anëtarësimin në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri;
- Zhvillimi i kapacitetit koordinuese të MEPJ nëpërmjet forcimit të Drejtorisë së BE-së (Sekretariatit të Integritimit Evropian) dhe misionit të Republikës së Shqipërisë në Bruksel, si dy hallka të rëndësishme të strukturës negociuese;
- Vijimi i komunikimit intensiv me vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit për të siguruar bashkëpunimin sa më të afërt dhe efektiv gjatë periudhës së shërbimit si anëtar jo i përhershëm i KS të OKB-së;
- Performanca e lartë e strukturave në MEPJ dhe e Misionit të Përhershëm të RSH në OKB, me qëllim realizimin e një përfaqësimi sa më dinjitoz në KS/OKB;
- Forcimi i marrëdhënieve me vendet e Rajonit dhe bashkëpunimit rajonal;
- Konsolidim i marrëdhënieve me Kosovën, përmes G2G, zbatimit të marrëveshjeve të përbashkëta, angazhimit për njohjen ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, etj.
- Forcimi i kohezionit të shqiptareve në rajon;
- Zhvillimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partnerët strategjik, vendet mike dhe aleate;
- Zbatimi i Strategjisë kombëtare të diasporës Shqiptare 2021-2025; mbështetja dhe organizimi i diasporës duke synuar rritjen e besimit të saj tek mekanizmat e zbatimit, regjistrimin e diasporës dhe rrjetëzimin e grupeve të profesionistëve në diasporë;
- Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për të gjetur mundësi dhe zbatuar projekte që i sjellin shqiptarët e diasporës gjithmonë e më afër vendit të tyre. Marrëveshje me vende të ndryshme që synojnë të ndihmojnë dhe lehtësojnë jetën e përditshme të diasporës (marrëveshje për njohjen e lejeve të drejtimit dhe ato për sigurimet shoqërore);
- Modernizimi i shërbimeve konsullore në përmbushje të detyrave që rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Diasporën, duke synuar përafrimin e diasporës me vendin, identifikimin e nevojave dhe problemeve të tyre dhe ndërmjetësimi për zgjidhjen e tyre në vendin pritës.

Në total, buxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2023 ka një ulje prej 5% krahasuar me atë të vitit paraardhës për shkak se drejtimi teknik dhe bashkërendimi i procesit të integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian tashmë i ka kaluar në kompetencë Kryenegociatorit, shoqëruar kjo edhe me buxhetin përkatës. Gjithashtu edhe Koordinimi i Programeve Kombëtare e Rajonale të IPA-s i ka kaluar Agjencisë Shtetërore të Programit Strategjik dhe

Koordinimin të Ndihmës (SASPAC), proces i cili shoqërohet edhe me kalimin e burimeve njerëzore dhe të fondeve buxhetore në strukturën buxhetore të institucioneve përkatëse.

Në këtë kuadër, përfaqësuesit e MEPJ dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave kërkuar nga Komisioni miratimin e një amendimi, në nenin 11 të projektligjit, i cili ka të bëjë me disa rishpërndarje brenda zërave të buxhetit sikurse dhe me shkrirjen e programit buxhetor për integrimin në programin e përgjithshëm organizativ të MEPJ.

Më tej, anëtarët e Komisionit diskutuan mbi projektbuxhetin dhe shprehën vlerësimet dhe sugjerimet e tyre për planifikimin e një buxheti që duhet të mbështesë nevojat për përmbushjen optimale dhe efektive të objektivave të politikës së jashtme.

Deputetë të opozitës ngritën shqetësimin për nivelin e ulët të buxhetit dhe domosdoshmërinë e rritjes së tij në një masë të konsiderueshme. Ata theksuan se ky nivel si dhe zvogëlimi i vazhdueshëm i buxhetit nga viti në vit dëmton performancën e diplomacisë shqiptare në momentet kritike të situatës ndërkombëtare. Një tjetër problem është edhe ai i fondeve tepër të pakta për financimin e projekteve për diasporën, të cilat kanë mbetur në letër.

Z. Etjen Xhafaj, në cilësinë e relatorit, u shpreh se projektbuxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në parim i plotëson nevojat në lidhje me detyrat e objektivat për vitin 2023. Ai shprehu mirëkuptimin për ndryshimet që justifikohen me transferimin e disa kompetencave nga MEPJ tek institucionet e tjera si dhe për faktin që kriza ndërkombëtare kërkon përpilimin e kujdesshëm të buxhetit.

Në përfundim të diskutimeve, znj. Mimi Kodheli, shprehu mbështetjen për buxhetin në kushtet e nevojës për menaxhimin e krizës dhe ftoi Komisionin për të votuar projektligjin nen për nen, përfshirë edhe ndryshimet e kërkuara nga MEPJ dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

PËRFUNDIME

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën, nenet 78,83, pika 1 dhe 158 të saj dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur dhe po shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme votoi (nen për nen) buxhetin 2023 për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe, pasi e miratoi atë, me shumicë votash (8 pro, 3 kundër), u shpreh dakord për kalimin e tij tek Komisioni për Ekonominë dhe Financat si komision përgjegjës për shqyrtim, miratim dhe paraqitje të projektligjit “ Për Buxhetin e vitit 2023” në seancë plenare.

RELATOR

Etjen XHAFAJ

KRYETARE

Mimi KODHELI